



Datë: 14.07.2025
Numër Protokolli: 5836/2025

A.nr.1007/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurës sipas ankesës me numër A.nr.1007/2025, të datës 29.05.2025, të parashtruar nga ankuesi R.H, kundër organit të punësimit: Agjencia Pyjore e Kosovës, në çështjen juridike *‘kërkesë nga marrëdhënia e punës’*, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datën 14.07.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa më numër A.nr.1007/2025, e datës 29.05.2025, e parashtruar nga ankuesi R.H.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil R.H (*tutje referuar vetëm ankuesi*), më datë 29.05.2025, përmes emailit ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër përgjigjes në ankesë të datës 15.05.2025, të u.d Drejtorit Ekzekutiv i Agjencisë Pyjore të Kosovës, lidhur me mos shqyrtimin e ankesës së datës 31.01.2025.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 02.06.2025, ka proceduar kërkesën në përgjigje në ankesë pranë Agjencisë Pyjore të Kosovës, ndërsa, kjo e fundit, më datë 05.06.2025, ka përcjell përgjigje në ankesë duke bashkangjitur provat materiale lidhur me çështjen ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 3613/2025 të datës 29.05.2025, e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Vendimin A.nr. 532/2025 të datës 06.05.2025 të KPMSHCK-së; Përgjigjen e datës 15.05.2025; Kopjen e ID-së së ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 02.06.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 05.06.2025; Akt Emërimin e datës 31.01.2012; Vendimin Ref:KE-514/23 të datës 25.08.2023; Vendimin Ref:KE-202/23 të datës 07.04.2023; Ankesën me numër protokolli 1920/2025 të datës 24.03.2025, e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Ankesën me numër protokolli 249 të datës 29.01.2025; Kërkesën me numër protokolli 267 të datës 31.01.2025; Ankesën me numër protokolli 3582 të datës 02.09.2024; Deklaratën me numër protokolli 4198 të datës 14.10.2024; Deklaratën me numër

protokolli 7010 të datës 29.11.2023; Ankesën me numër protokolli 4626 të datës 25.11.2024; Kopjen e ID-së së ankuesit; Emailin e datës 23.03.2025 të ankuesit për ankesa.kpmschck@rks-gov.net; Kërkesën e datës 24.03.2025 të ankuesit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për mbajtje të seancës dëgjimore; Ankesën me numër protokolli 334 të datës 07.02.2025; Ankesën me numër protokolli 453 të datës 18.02.2025; Ankesën e numër protokolli 223 të datës 27.01.2025; Deklaratën me numër protokolli 673 të datës 06.03.2025; Kërkesën me numër protokolli 1068 të datës 06.03.2024; Ankesën me numër protokolli 7011 të datës 29.11.2023; Ankesën me numër protokolli 7502 të datës 05.12.2023; Kërkesën me numër protokolli 2516 të datës 16.06.2023; Ankesën me numër protokolli 4298 e datës 05.10.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 01.04.2025; Kërkesën me numër protokolli 01 e datës 03.01.2024; Kërkesën me numër protokolli 8065 të datës 18.12.2023; Kërkesën me numër protokolli 7503 të datës 05.12.2023; Kërkesën me numër protokolli 7502 të datës 05.12.2023; Tabelën e stafit të APK lidhur me përvojën e punës dhe moshën e datës 31.12.2023; Kërkesën e me numër protokolli 3740 e datës 25.09.2023; Kërkesën me numër protokolli 3903 të datës 09.09.2023; Kërkesën me numër protokolli 5191 të datës 21.11.2022; Ankesën me numër protokolli 3393 të datës 30.08.2022; Kërkesën me numër protokolli 3521 të datës 11.09.2023; Vendimin me numër protokolli 4642/2025 të datës 10.07.2025 për shtyrjen e afatit për vendosje të ankesës së ankuesit.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë ka gjetur se ankesa e ankuesit është e palejuar, **sepse**:

Nga administrimi i provave të lëndës rrjedhë së ankuesi sipas Akt Emërimit ZP-83/2012, të datës 31.01.2012, mbanë pozitën e punës Zyrtar për Çështje Ekonomike, në Drejtorinë Koordinuese Gjilan, pranë Agjencisë Pyjore të Kosovës.

Tutje nga shkresat e lëndës rezulton së ankuesi fillimisht më datë 29.11.2023, ka parashtruar shkresë më emërtimin deklaratë tek zv. Drejtori Ekzekutiv i APKS-së, me të cilin ka deklaruar se nga kthimi në vendin e punës më datë 04.02.2022, është përballuar me linqime, sabotime dhe mos dhënie të detyrave që i përkasin, ndërsa, më datë 11.10.2024, serish parashtron shkresë tek ud.Drejtori Ekzekutiv i APK-së me emërtim deklaratë, lidhur me përballjen e tij me pengesa e vështirësi pse sinjalizon dhe vazhdon të ankimoj për transferimin e përhershëm të zyrtarit B.Rr.

Meqë pretendon se nuk ka marr përgjigje në kërkesat apo deklaratat e tij, ankuesi më datë 29.01.2025, ka parashtruar shkresë me numër protokolli 249, me emërtim ankesë, përmes të cilës ka kërkuar nga Drejtori Ekzekutiv i APK-së, përgjigje ndaj ankimit për përfundimin e procedurës administrative, lidhur me ankesën mbi përballje me linçim duke tentuar të më linçojnë para stafit dhe palëve, si dhe më datë 31.01.2025 ka parashtruar kërkesë me numër protokolli 267 lidhur me transferimin e përhershëm të nëpunësit B.Rr, me qëllim të shmangies së konfliktit të vazhdueshëm të interesit dhe shqiptimit i transferimit si masë e pamjaftueshme profesionale. Mirëpo, që sipas provave të lëndës nuk ka marr përgjigje.

Ankuesi kundër heshtjes administrative të Drejtorit Ekzekutiv të APK-së, më datë 24.03.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke kërkuar që të detyrohet Drejtori Ekzekutiv i APK-së që të shqyrtoj kërkesat e tij. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 06.05.2025, ka nxjerr Vendim A.nr.532/2025, ka aprovuar ankesën e ankuesit duke ka detyruar Drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë Pyjore të Kosovës që të shqyrtoj kërkesat e ankuesit të datës 29.10.2025 dhe 31.01.2025.

U.D Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Pyjore të Kosovës, më datë 15.05.2025, ka dhen përgjigje në kërkesat e ankuesit të datës 29.01.2025 dhe 31.01.2025, ashtu që, ka njoftuar të njëjtin së kërkesat refuzohen sepse ankuesi lidhur me pretendimet për linçime publike, marginalizim, diskriminim, shpifje, përgojim, bullizëm dhe skenar të fabrikuar, nuk i ka mbështetur më prova dhe fakte konkrete.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se ankesat e tij nuk janë shqyrtuar për faktin se kanë qenë të ndryshme dhe aspak nuk qëndrojnë ato që janë thënë në përgjigjen e datës 15.05.2025. Kërkon të aprovohet ankesa dhe të detyrohet APK-ja që të nxjerr vendim lidhur me ankimin e datës 31.01.2025.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmërinë e ankesës së ankuesit iu referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 27 paragrafi 3 ku përcaktohet se: 3. *Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil, si dhe dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 124 ku përcaktohet se: 1. Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim...”, dhe si rrjedhojë referuar dispozitave përkatëse ligjore konstatoi se nëpunësi civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme të cilat burojnë nga marrëdhënia e punës, mirëpo, në rastin konkret ankuesi nuk ka rritur të argumentoj së cilat janë veprimet apo mosveprimet e organit të punësimit që kanë cenuar të drejtat e tij nga marrëdhënia e tij e punës, rrjedhimisht, ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill ka dhënë deklaratime të përgjithësuar duke mos saktësuar dhe argumentuar se cilat veprime apo mosveprime kanë linçuar ankuesin, diskriminuar apo cilat kanë qenë shpifjet në raport me ankuesin.*

Lidhur me pretendimin për transferim të zyrtarit B.R, Kolegji nga analizimi i shkresave të lëndës ka gjetur së më Vendimin nr.protokolli 1514, të datës 07.04.2023, të Zv. Drejtorit Ekzekutiv të APK-së, Zyrtari B.Rr në pozitën e Drejtorit të DKR-APK-Gjilan, është transferuar përkohësisht dhe për nevoja të institucionit në pozitën e Drejtorit të Drejtorit atit Koordinues Regjional në Prishtinë, ndërsa, më Vendimin nr. protokolli 3370, të datës 25.08.2023, të Zv.Drejtorit Ekzekutiv të APK-së, z. B.Rr. kthehet në pozitën e tij të punës si Drejtor në DKR-Gjilan. Rrjedhimisht, ankuesi edhe pse konteston vendimin nr.potkolli 1514, të datës 07.04.2023, për transferimin e përkohshëm të B.Rr, i njëjti nuk ka arritur të sqaroj dhe argumentoj së cila e drejta apo cili interes i tij është cenuar si rezultat i nxjerrjes së këtij vendimi. Andaj, duke marr parasysh që vendimi për transferim të nëpunësve civil është vendim i udhëheqësit më të lartë administrativ dhe duke qenë së transferimi ka të bëjë më një zyrtar tjetër, atëherë, ky i fundit ka legjitimitetin ta kundërshtoj këtë vendim në rast të pretendimeve për paligjshmëri, kështu që, mbi këto rrethana dhe konstatime rrjedhë së në çështjen ankimore, ankuesit i mungon legjitimiteti i palës siç parashihet më nenin 14 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: 1. *Palë në procedurën administrative mund të jetë çdo person fizik, person juridik apo grup personash me një interes të përbashkët: 1.1. me kërkesë të të cilit organi publik ka filluar procedura administrative; 1.2. ndaj të cilit ka filluar procedura administrative apo të cilit rezultati i procedurës administrative mund t'i cenojë të drejtat apo interesat juridike.*

Thënë si më sipër, Kolegji i Këshillit vlerëson se ankesa e ankuesit është e papranueshme në kuptim të nenit 129, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që, duke u bazuar në nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda: A.nr.1007/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit R.H;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Agjencisë Pyjore të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së